

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-22/09-06

Prishtinë, më 27 prill 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtuan **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit dhe **Sabri HAMITI**, anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 79 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 6 prillit 2006;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për auditimin e brendshëm;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arbitrazhin;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin riprodhues;
6. Shqyrtimi i informatës së Qeverisë së Kosovës për parandalimin e gripit të shpendëve;
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Media për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqiten këta deputetë:

Enver Hoxhaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që në rend dite të kësaj seance, si çështje e ngutshme, të radhitet për shqyrtim Udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Universitetin e Prishtinës.

Gjylnaze Sylaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se në seancën e sotme nuk mund të shqyrtohet gjendja në Universitetin e Prishtinës, por Kuvendi në një seancë të veçantë të diskutojë për gjendjen e arsimit në tërësi.

Teutë Sahatçija, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se e mbështet kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta shqyrtuar gjendjen në Universitetin Prishtinës, si çështje të ngutshme.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se nuk duhet të politizohet çështja e arsimit. Opozita mund t'i parashtrijë pyetje parlamentare ministrit të Arsimit ose ta ftojë atë në interpelancë.

Për ta shqyrtuar çështjen e arsimit në Kuvend, paraprakisht duhet të bëhen përgatitjet e nevojshme.

Ferid Agani, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim”, tha se e mbështet kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së. Ai kërkoi që të takohen kryetarët e grupeve parlamentare që të merren vesh për procedimin e kësaj çështjeje..

Hydajet Hyseni, përsëriti çështjen e pyetjeve parlamentare, të cilat i kishte parashtruar më herët, por nuk kishte marrë përgjigje. Ai kërkoi që në seancën e radhës të përgjigjen ministrat përkatës për pyetjet e parashtruara.

Xhavit Haliti, kërkoi sqarime nga ART-ja lidhur me përdorimin e frekuencave të telefonisë mobile në rajonin e Pejës. Ai pyeti ministrin e Punëve të Brendshme pse nuk po e mbështesin ART-në për largimin e antenave ilegale?

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votë kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta radhitur në rend dite të kësaj seance situatën në Universitetin e Prishtinës. Rezultati ishte si vijon:

Për-----29,
Kundër-----47;
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta radhitur në rend dite të kësaj seance, situatën në Universitetin e Prishtinës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kuvendi miratoi rendin e ditës të kësaj seance në formën e propozuar.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 6 prillit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 6 prillit 2006 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për auditimin e brendshëm

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Haki Shatri, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Shatri** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Shatri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Gani Koci, Mazllun Kumnova, Husnija Beshkoviq, Nazim Jashari dhe Ferid Agani**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 62;

Kundër----- 1.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për auditimin e brendshëm.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arbitrazhin

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri Lutfi Haziri, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendëskryeministri **Haziri** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendëskryeministri **Haziri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sadudin Berisha, Nerxhivane Dauti, Xhevdet Neziraj, Husnija Beshkoviq, Nazim Jashari, Ramadan Kelmendi dhe Lumnije Hyseni**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 66;

Kundër-----1.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në **parim** Projektligjin për arbitrazhin.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqes Kuvendit raportin për miratim

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin riprodhues

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Sadik Idriz, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Idrizi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nurishahe Hulaj, Teutë Hadri, Zylfije Hundozi, Shpresa Murati, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Ferid Agani, Fehmi Vula dhe Flora Brovina**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 64;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në **parim** Projektligjin për shëndetin riprodhues.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

6. Shqyrtimi i informatës së Qeverisë së Kosovës për parandalimin e gripit të shpendëve

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që t'i informonte deputetët e Kuvendit për masat e marra për parandalimin e gripit shpendëve.

Ministri **Sadik Idrizi** para deputetëve të Kuvendit paraqiti aktivitetin e Ministrisë së Shëndetësisë për parandalimin e gripit të shpendëve.

Në vazhdim ministri Idrizi foli për prejardhjen e sëmundjes të gripit të shpendëve, si dhe për rrezikun e përhapjes së saj me virusin H5N1, që shkakton vdekjen e njerzëve.

Gripi i shpendëve është lajmruar në disa vende rreth Kosovës. Prandaj Qeveria e Kosovës ka marrë masat e nevojshme për parandalimin e saj: Ka formuar Shtabin e Krizës në nivel vendi, si dhe shtabet lokale.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik ka miratuar planin aksional për parandalimin e pandemisë.

Janë publikuar dhe shpërndarë njëzetmijë broshura (në dy gjuhë) për t'i informuar qytetarët për rrezikun dhe mbrojtjen nga kjo sëmundje. Janë aftësuar punëtorët shëndetësorë, pjestarët e SHKK-së dhe të TMK-së për t'u dhënë ndihmë eventuale qytetarëve të prekur nga kjo sëmundje. Në rast të paraqitjes së saj Qeveria do të kërkojë ndihmë edhe nga organizatat shëndetësore ndërkombtare, për ta përballuar më lehtë situatatën. Jemi duke bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë për t'i bashkërenditur aktivitetet në parandalimin e kësaj sëmundjeje.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** i informoi deputetë e Kuvendit për aktivitetet që i ka marrë Ministria e Bujqësisë lidhur me parandalimin e gripit të shpendëve. Ministria më 23 shtator ka nxjerr Udhëzimin administrativ për aviofluencën dhe sipas këtij udhëzimi nëpërmjet Agjencisë për Ushqimit ka kërkuar ndihmë edhe nga PSSP-ja për pjesën e rezervuar, që është pajtuar me kërkesat tona dhe ka nënshkruar Udhëzimi administrativ 32/2005.

Ministria ka përgatitur programin emergjent dhe i kemi bërë të gjitha ndalesat e importit të artikujve ushqimorë me origjinë shpendësh, varësisht nga datat dhe vendet ku janë paraqitur sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Organizatës Botërore të ushqimit. Qeveria e Kosovës ka ndarë një sasi mjetesh prej 392 mijë e 425 euro për blerjen e aparaturës përgjegjëse.

Kemi bërë analizat e mostrave, ku nga 561 raste të bëra në Institutin e Veterinës dhe të Ushqimit të Kosovës, të gjitha kanë treguar rezultat negativ.

Informimit i kemi kushtuar kujdes dhe kemi shpërndarë dhjetë mijë broshura, fletëpalesa dhe posterë, kemi incizuar dy filma televizivë.

Gjithashtu kemi kushtuar edhe riinspektimin e depove, ku kemi të koncentruara sasi të konsiderueshme të artikuj ushqimorë me origjinë shpendësh dhe mbi 270 mostra të analizuar kanë rezultuar negativ.

Për të parandaluar këtë sëmundje kemi filluar me masa dezinfektuese në pikat kufitare. Kemi përgatitur të gjitha planet dhe programet emergjente për parandalimin e gripit të shpendëve. Na nevojiten e dhe 17 milion €, që i kemi kërkuar nga Banka Botërore, por ende nuk kemi marrë përgjigje.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me parandalimin e sëmundjes së etheve hemorragjike dhanë këta deputetë: **Fehmi Vula, Teutë Hadri, Zylfije Hundozi, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Xhevat Bislimi, Bajram Rexhepi, Nurishahe Hula, Behxhet Brajshori, Gjylnaze Sylja, Rifat Krasniq dhe Flora Brovina**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Në fund të debatit, ministri **Sadik Idriz** dhe zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** iu përgjigjen pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës miratoi informatën e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e gripit të shpendëve me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve.

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Parlamentar Ad Hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e këtij komisioni ta arsyetonte rekomandimin para deputetëve të Kuvendit.

Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit Parlamentar Ad Hoc (17 anëtarësh) për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media, tha se katër (4) anëtarët që komisioni ia ka rekomanduar Kuvendit janë përzgjedhur nga tetë (8) të propozuar nga shoqëria civile. Komisioni ka punuar me konsensus. Është votuar në mënyrë të fshehtë dhe janë radhitur sipas numrit të votave që kanë marrë.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit t'i miratonin kandidatët e propozuar.

Kryetari e hodhi në votë rekomandimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc në këtë përbërje:

1. Filloreta Bytyçi,
2. Milena Gjericq,
3. Ilir Dugolli dhe
4. Isuf Berisha.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----57;
Kundër-----11;
Abstenime---6.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi rekomandimin Komisionit Parlamentar Ad Hoc për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 14:15 minuta.

E hartoi

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
